

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti , në çështjen e inicuar me padin e paditëseve [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Ferizaj, puntore në SH.F [REDACTED] në [REDACTED], kundër të paditurave Ministra e Shërbimeve Publike në Prishtinë dhe Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, në çështjen juridike kompenzimin e të ardhurave personale, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 31.07.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

-pa shqyrtim kryesor të çështjes -

I. REFUZOHET, në tërësi si e pa themeltë, kërkesëpadija e paditëseve [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Ferizaj, puntore në SH.F [REDACTED] në [REDACTED], kundër të paditurave Ministra e Shërbimeve Publike në Prishtinë dhe Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit me të cilën kanë kërkuar që të detyrohen të paditurat t'ia kompenzojnë të ardhurat personale të pa paguara për punën e kryer për muajin nëntor dhe dhjetë ditë të muajit dhjetor 2007, me kamat ndëshkuese duke llogaritur nga data 01.02.2008 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 8 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditëset në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurave, me pretendimin se gjatë kohës së fushatës parazgjedhore për zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, kanë qenë kandidat në listat zgjedhore. Gjatë kohës së fushatës parazgjedhore, paditëset me rregull i kanë mbajtur orët mësimore, kështu që procesi mësimor nuk ka pësuar çrregullime. Të paditurat pa të drejtë ua ndalin paditëseve të ardhurat personale për punën e kryer gjatë fushatës parazgjedhore (muajin nëntor dhe dhjetë ditë e para të muajit dhjetor 2007), të paditurat gjithashtu nuk i ka përmbushur në tërësi obligime që dalin nga Udhëzimi Administrativ nr.2003/2 për zbatimin e rregullores së UNMIK-ut nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës nga se nuk na është dhënë pushim pa pagesë për kohën sa ka zgjatë fushata elektorale dhe nuk është siguruar zëvendësim adekuat.

Gjykata, pasi që ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka obliguar të paditurat që të parashtrorë përgjigje në padin e paditëseve. I autorizuar i të paditurës Komuna Ferizaj me datën 17.09.2015 në afatin ligjorë, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën e ka kontestuar në tërësi padin dhe kërkesëpadin e paditëseve si të pa bazuar, sepse në zgjedhjet komunale të 17 nëntorit të vitit 2007, paditëset kanë qenë në listat zgjedhore, dhe se duke mos i zbatuar dispozitat ligjore nuk kanë kërkuar pushim pa pagesë gjatë kohës së fushatës parazgjedhore. Paditëset në kërkesëpadin gjithashtu nuk e kanë cekur fare shumën e mjeteve të cilat i kërkojnë në emër të kompenzimit të pagave dhe as bazën juridike për një pagesë të tillë.

Bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe vlerësimin e tyre, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia është e pa bazuar.

Gjykata nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ka konstatuar se ndërmjet palëve nuk ka qenë kontestuese se paditëset në zgjedhjet komunale të 17 nëntorit të vitit 2007, kanë qenë në listat zgjedhore, dhe se gjatë kësaj periudhe paditëseve, e paditura ua ka ndalë pagën për muajin nëntor dhe dhjetë ditë të muajit dhjetor 2007.

Gjykata konsideron se pretendimet e të paditurës të paraqitura në përgjigje në padi të dt.17.09.2015 se padia e paditëseve është e pa bazuar, gjykata ka konstatuar se ky pretendim qëndron pasi që me dispozitat ligjore të nenit 28.4 të Udhëzimit Administrativ nr.2003/02, për zbatimin e rregullores së UNMIK-ut nr.31/36 është paraparë: " *Pos sekretarëve të përhershëm, nëpunësve kryesorë ekzekutivë dhe drejtorëve të departamenteve, nëpunësit civilë mund të paraqesin kandidaturën për ndonjë funksion të zgjedhur publik, por ata duhet të marrin pushim pa pagesë nga Shërbimi civil, i cili fillon nga data kur ata publikisht i shpallin kandidaturat e tyre.*, andaj në rastin konkretë paditëset nuk e kanë respektuar këtë dispozitë, nuk kanë bërë kërkesë për lejimin e pushimit pa pagesë dhe kështu kanë marrë pjesë në fushatën parazgjedhore si kandidatë për funksione publike, pa marrë pushim pa pagesë me qëllim që të realizojnë paga edhe në këtë periudhë kohore. Kështu që Ministria e Shërbimeve Publike në bazë të të dhënave që ka poseduar nga KQZ-ja, nëpërmes Ministrisë së Financave ua ka ndal pagën për periudhën e cekur sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi, çka do të thotë se këtë periudhë ua ka llogaritur si pushim pa pagesë.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur ne baze nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha me sipër është vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.36/08, me datën 31.07.2018



Gjyqtari,
Enes Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

